



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0209

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Batisha Ibrahimimi dhe Kimete Gashi Brajshori - anëtare, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “Astraplan” SH.P.K., kundër Mosekzekutimi i vendimit të OSHP-së të “POLICIA E KOSOVËS” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “NDERTIMI I STACIONIT POLICOR VERI PRISHTINË” me numër të prokurimit 214-22-10936-5-1-1, me 10/06/2025, mori:

Vendim

- 1. Apropohet**, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE “Astraplan” SH.P.K. me nr. 2025/0209, e datës 29/03/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “NDERTIMI I STACIONIT POLICOR VERI PRISHTINË” me numër të prokurimit 214-22-10936-5-1-1.
- 2. Mbetet në fuqi**, Njoftimi mbi vendimin e AK për anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit me titull të përshkruar si në pikën I të këtij dispozitivi.
- 3. Kthehen mjetet e deponuara** në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik “Astraplan” SH.P.K

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 14.10.2022, “POLICIA E KOSOVËS” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: “NDERTIMI I STACIONIT POLICOR VERI PRISHTINË” me nr. të prokurimit: 214-22-10936-5-1-1. Ndërkaq me datën 13.03.2025 është publikuar njoftimi mbi vendimin e AK për anulim të aktivitetit të prokurimit.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës punë dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 1 538 842,70 €

Me 17.03.2025, OE “Astraplan” SH.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 21.03.2025, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 29.03.2025, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “Astraplan” SH.P.K me nr. 2025/0209 lidhur me aktivitetin “NDERTIMI I STACIONIT POLICOR VERI PRISHTINË” me numër të prokurimit 214-22-10936-5-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Ankesa është e përsëritur, lidhur me këtë lëndë janë nxjerr vendimet e mëparshëm të OSHP - së, më Nr. 373/23, vendimi nr.762/23, 101/24 dhe vendimi 725/24 .

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Astraplan” SH.P.K janë parashtruar si në vijim:

Ky aktivitet i prokurimit që nga shpallja e tij është anuluar disa herë dhe është kthyer në ri-vlerësim me 4 (5) vendime nga ana e OSHP-së.

Vendimet paraprake të

1. PSH Nr. 2023/0356, 2023/0373, 2023/ 0389, me 01.08.2023.
2. PSH Nr. 2023/0762; me 23.11.2023.
3. OSHP:2024/0101; me 29.03.2024.
4. OSHP: 2024/0725 me 29/10/2024.
5. Vendim për Diskualifikim nr. 80-24 me 30.10.2024.

Ndërsa anulimi i fundit është bërë më 12.03.2025, kurse ne e kemi pranuar të njëjtin vendim më dt. 13.03.2025. 17.03.2025 Ne si OE Astraplan bëjmë Kërkesë për rishqyrtim- e pesta me radhë, ndërsa me 21.03.2025- Refuzimi i kërkesës për ri-shqyrtim nga Fejza.

Me datën 26.03.2025 është publikuar një dokument i zbrazet (“blanko”) me titullin: Drejtoria_e_Prokurimit_Policia_e_Kosoves-1_(1)_250326_113024 dhe atë mbi dokumentin e dates 01.02.2024, kjo tregon se është duke u munduar që ti fshehë (zhdukë) faktet e shkeljeve që ka kryer në këtë aktivitet, shih foton e mëposhtme si zhduken dëshmitë e shkeljeve!

Këto janë prova te mjaftueshme që OSHP-ja të marrë masa duke lëshuar URDHERESË për zbatimin e vendimeve të OSHP-s nga Autoriteti Kontraktues, gjegjësisht Artan Fejza.

Një përshkrim i shkurtër si rikujtim për OSHP-ë, se Artan Fejza me manipulimet që është duke i bërë në këtë aktivitet dhe është duke u munduar të anulohet për të shpërblyer dastat me vone me të njëjtin projekt, e që tash me e kanë kuptuar të gjithë.

Dëshmia kryesore që vërteton se Fejza po e din që është duke bërë shkelje flagrante dhe të rënda të LPP-s është edhe nënshkrimi i raportit dhe vendimit për anulim nga zyrtari i prokurimit (për Artan Fejza) dhe jo nga vet Fejza, mirëpo ky zyrtari e ka zbatuar urdhrin e Fejzës.

Nga Vendimi i fundit i OSHP-s me 29.10.2024 ka qenë afati për ri-vlerësim 30 ditë max 50, ndërsa ju keni tejkaluar afatet ligjore 4fish (135 ditë).

Neni 7 i LPP-së - Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi AK-ja ka bërë diskriminimin e kompanisë tone pasi që i kemi plotësuar të gjitha kërkesat në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontrate dhe kemi çmimin me të lirë si OE me renditjen nr. 1 I përgjegjshëm. AK-ja ka qenë e obliguar që të analizojë kërkesën në Neni 9.1 & 9.2 të DT-s - Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale në DT dhe në njoftim për kontratë, pasi që në rastin konkret të gjitha i kemi plotësuar.

Në dokumentin e dorëzuar me oferte në platformën e e-prokurimit:

1. (dokumenti me nr. 5.1 LISTA E STAFIT TE INXHINIERAVE PJESA 1, dhe 5.2 LISTA E STAFIT TE INXHINIERAVE PJESA 2),

2. Në këto dy dokumente janë të gjitha dëshmitë dhe se janë të gjitha të vërteta.

Ke kërkesën nr. 2 të Neni 9.1 & 9.2 të DT-s në pjesën e dëshmisë kërkohet (• Kontrata ose para kontrata e punës valide me punëdhënësin), prej nga manipulimi i juaj që keni kryer Artan Fejza me listat e ATK-s dhe komunikimet në ATK vetëm sa e vërteton atë që kemi thënë deri më tani, se ju jeni duke vepruar në ndikimin e interesit personal për të na dëmtuar neve si OE, për inatet tuja personale që ke me neve, dhe atë në kundërshtim me LPP-n dhe RRPP-n, vetëm e vetëm pse e keni pozitën dhe po mundeni të kryeni një shkelje të tillë.

Të gjithë stafin që e kemi prezantuar dhe që nuk janë të punësuar me kontratë të rregullta i kemi bashkangjitur para kontratës, dhe kjo është treguesi më i mirë se na keni diskriminuar në mënyrën me të pa shkrullt për arsye të meqenësme:

3. Në kemi deklaruar se i kemi bashkëpunëtor, e jo të punësuar. Këtë e vërteton edhe parakontrata që është në emër të projektit dhe vetëm për këtë projekt.

4. Në dosje të tenderit nuk është kërkuar që stafi duhet të jetë i regjistruar në ATK-për dorëzimit të tenderit, këtu keni manipuluar me dokumentet e tenderit.

5. Deklaratën në lidhje me orarin 8 orësh e keni kërkuar ju më datën 11.01.2024 në pyetjen nr.1, dhe kjo nuk don koment që e keni përmendur në arsye të eliminimit, vetëm sa për të shkruar diçka.

6. Fillimisht një oferte duhet të jetë e përgjegjshme administrativisht e pastaj të kalkulohen gabimet aritmetikore, nga kjo ju sqarojmë se me datën 06.12.2023 kemi pranuar-Letër standarde kërkesë për sqarimin e tenderit dhe me datën 07.12.2023 kemi dorëzuar Përgjigje ne Letër standard kërkesë për sqarimin e tenderit, duke u bazuar ne përgjigjen që kemi dhënë vërehet qartë se komisioni i vlerësimit e ka vlerësuar administrativisht ne rregull ofertën tone dhe ka kërkuar me datën 14.12.2023 -Letër standarde për sqarimin e tenderit llogaritje e gabuar, ku edhe kësaj ju kemi përgjigjur me 15.12.2023

7. Ne 3 ose 4 vlerësimet e komisionit brenda AK-s dhe 5 vendimet e OSHP-s: PSH Nr. 023/0356, 2023/0373, 2023/ 0389, dt. 01.08.2023, PSH Nr. 2023/0762; dt. 23.11.2023, OSHP:2024/0101; dt. 29.03.2024, OSHP: 2024/0725 dt. 29/10/2024, Vendim për Diskualifikim nr. 80-24 dt. 30.10.2024

8. këto kërkesa që ju tash i keni ngritur janë vlerësuar plotësisht ne përputhje me kërkesat e DT dhe i kanë plotësuar kërkesat e DT-s dhe NJK,

9. Ju si AK në rastin konkret si arsye të eliminimit tonë nga ky aktivitet i prokurimit i referohet një kriteri i cili nuk ka qenë pjesë e dosjes së tenderit (dokumentet nga ATK te kërkuara nga Autoriteti Kontraktues si “sqarime” nuk kanë qenë kërkesë në njoftim për kontratë dhe dosje të tenderit, andaj përdorimi i tyre për vlerësim dhe eliminim tonë është në kundërshtim të plotë me dispozitat e nenit 7 të LPP-së, par.6, pika).

10. Gjithashtu ju bëj me dije se për inxhinieret e apostrofuara nga AK-ja, që ne kemi prezantuar për këtë aktivitet të prokurimit, në kompani Astraplan shpk janë me parakontratë (në cilësi të bashkëpunëtorëve profesional), dhe se të njëjtit nuk janë në marrëdhënie të përhershme të punës.

Pra autoriteti kontraktues konkretisht z. Artan Fejza qëllimisht tenton të dezinformon Panelin Shqyrtues, duke tentuar të manipulojë me termin i punësuar në vend të termit bashkëpunëtor profesional me parakontratë për projektin e lartcekur, gjithashtu tenton të ndryshoj kriterin e DT-s, nga punëtor me parakontrata ne punëtorë të rregullt me liste të ATK-s, kjo përbën shkelje të rënde sepse kjo është e rregulluar shumë qartë edhe me Ligjin Nr. 04/L-077 Për Marrëdhëniet e Detyrimeve- Nenit 33, par.1. Citat “Parakontrata është kontratë me të cilën merret përsipër detyrimi që më vonë të lidhet kontrata tjetër kryesore.”

11. Tentimi i autoritetit kontraktues për përlegjen e vendimit për eliminim tonë dhe anulim të këtij aktiviteti të prokurimit, duke apostrofuara KRRPP-ën është absurd i llojit të vet, kur fare mirë dihen kompetencat e Organit Rregullativ për Prokurim Publik të cilat janë të përcaktuara me nenin 87 të LPP-së. I’a përkujtojë autoritetit kontraktues se bazuar në dispozitat e LPP-së, vendimet e panelit shqyrtues të OSHP-së janë vendime përfundimtare dhe obligative për të gjitha palët në procedurë, dhe mos zbatimi i tyre përbën vepër penale.

Neni 72 i LPP-së Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

Ju Artan Fejza keni vepruar ne kundërshtim me nenin 72, paragrafi 1; Citojmë paragrafin 1: Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati të caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në

përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.

Shih ne foton e me poshtme te nënvizuar deshmin e diskriminimit qe e ka vërtetuar OSHP-ja

Ju nuk keni te drejte e as nuk ju lejon LPP-ja qe te kërkonit sqarime jashtë atyre kërkesave qe janë vendosur ne DT-s dhe ne Njoftimin për Kontrate.

Neni 56 i LPP-së - Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave Autoriteti kontraktues me rastin e eliminimit tonë nga ky aktivitet i prokurimit ka bërë shkelje të nenit 56 par 3 të LPP-së, sepse referuar nenit në fjalë citat:” Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”. Pra arsyet e eliminimit tonë për kriter i cili nuk ka qenë i paraparë as në njoftim për kontratë e as në dosje të tenderit rezulton se është i kundërligjshëm dhe i qëllimshëm nga Artan Fejza dhe atë pse ja kemi prishur matematikat për përfitime personale dhe për shkak te inateve personale qe ka me neve si kompani, shkelje shume e rëndë.

Neni 59 i LPP-së – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve Autoriteti kontraktues me rastin e eliminimit tonë nga ky aktivitet i prokurimit ka bërë shkelje të nenit 59 par.4 të LPP-së, sepse komisioni vlerësues pranë autoritetit kontraktues në mënyrë të kundërligjshme ofertën tonë edhe pse ka qenë ofertë e përgjegjshme konform njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit të njëjtën e ka cilësuar si ofertë të papërgjegjshme edhe ekspertet shqyrtues te OSHP-s dhe PSH i OSHP-s me vendimet e veta. Kurse konform nenit 59 par.4 të LPP-së, Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit, qe do te thotë se ne jemi eliminuar kundërligjshëm dhe qëllimshëm.

Paragrafi 1 i nenit 59: Autoriteti kontraktues do të themeloj një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës.

DMTH komisioni e ka ditur qe janë ne kundërshtim me kërkesat e DT-s dhe pikërisht për këtë arsye nuk ka kërkuar sqarim për këtë pike dhe nuk ka komunikuar me ATK-n., ju e keni detyruar qe te thirret ne komunikimet tuaja te pa ligjshme qe keni kryer ne fillim te vitit 2024.

Këtu Artan Fejza keni shkelur neni 59 te LPP-s, nenin 39 dhe 40 te RRPP-s, pasi qe keni ndërhyrë ne vlerësim dhe keni ndikuar te komisioni, dëshmi shkresat qe keni komunikuar me komisionin dhe duke manipuluar kërkesat dhe shkresat ne kundërshtim me LPP-n, keni gënjyer duke i vu ne lajthitje komisionin për “dëshmi te rreme”, ne fakt ju Arton Fejza keni dhënë dëshmi te rreme.

Neni 69 i LPP-së- Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

AK-ja ne kundërshtim me nenin 69 edhe pse i kemi plotësuar te gjitha kërkesat e nenit 9.1 dhe 9.2 te DT-s, nuk na ka rekomanduar për dhënie te kontrates edhe pasi qe neve si ose Astraplan shpk na ka eliminuar edhe pse i kemi plotësuar te gjitha kërkesat sipas Neni 9.1 & 9.2 te DT-s

Neni 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit, paragrafi 2.

Autoriteti kontraktues-Policia e Kosovës, me rastin e anulimit të këtij aktiviteti të prokurimit ka bërë shkelje të nenit 62 par.1 dhe 2 të LPP-së, sepse në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet e parapara në nenin 62 par.1 dhe 2 të LPP-së, ngase oferta jonë ka qenë ofertë e përgjegjshme dhe atë conform njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit.

Neni 105 i LPP-së - Kompetencat e OSHP-së – Drejtori i zyrës së prokurimit pran Policisë së Kosovës, ka shkelur këtë nen dhe ka vepruar në kundërshtim me 5 vendimet e OSHP-s: PSH Nr. 023/0356, 2023/0373, 2023/ 0389, dt. 01.08.2023, PSH Nr. 2023/0762; dt. 23.11.2023, OSHP:2024/0101; dt. 29.03.2024, OSHP: 2024/0725 dt. 29/10/2024, Vendim për Diskualifikim nr. 80-24 dt. 30.10.2024, me çka OSHP-ja do të duhej në ditët në vazhdim të ju revokoj Certifikatën e prokurimit Artan Fejzës.

OSHP-ja ka vërtetuar me 5(pesë) vendimet e saj se në si OE jemi eliminuar kundërligjshëm dhe për kundër kësaj ZPP-Artan Fejza na eliminon përsëri duke refuzuar që të zbatojë vendimet e me sipërme të OSHP-s.

Autoriteti kontraktues me rastin e anulimit të këtij aktiviteti të prokurimit ka vepruar në kundërshtim me vendimet e OSHP-s, pasi që OSHP-ja kishte aprovuar ankesën tonë si të bazuar duke konstatuar se oferta e jonë për këtë aktivitet të prokurimit ka qenë ofertë e përgjegjshme, konform njoftimit për kontratë dhe Dosjes së Tenderit. Konstatim të tillë kishin bërë edhe ekspertët shqyrtues të OSHP-ës duke përfshirë edhe ekspertin teknik. Pretendimet tona ankimore ishin për arsye të njëjta dhe për kritere të njëjta për të cilat na ka eliminuar autoriteti kontraktues.

Shtoj gjithashtu se në vendimin e OSHP-së OSHP:2024/0101 të dt.29.03.2024 paneli shqyrtues ka konstatuar ndër të tjera citat: ” Po ashtu, Paneli Shqyrtues thekson se ky aktivitet i prokurimit është iniciuar në vitin 2022 dhe është ankesa e 5 (pestë) me radhë për të cilat OSHP ka nxjerrë vendim, dhe për të gjitha këto ankesa OSHP ka nxjerrë vendime duke u bazuar gjithmonë në dispozita ligjore dhe konform rekomandimeve të ekspertëve shqyrtues përfshirë edhe ekspert teknik. Vendimet paraprake të PSH Nr. 2023/0356, 2023/0373, 2023/ 0389, 2023/0762 si dhe përfshirë tani edhe këtë vendim. Prolongimi i deritanishëm i këtij aktiviteti të prokurimit në bazë të konstatimeve të Ekspertëve Shqyrtues dhe konstatimeve të Paneleve Shqyrtuese, ka ardhur si rezultat i shkeljeve të vazhdueshme të bëra nga ana e autoritetit kontraktues. Kështu që, këto veprime të AK nuk mund të shihen ndryshme pos si veprime tendencioze dhe në dëm të operatorëve ekonomik dhe vet institucionit, duke mos i vlerësuar ofertat konform nenit 59 dhe 60 të LPP” (fq.11)

Bazuar në paragrafin e mësipërm të vendimit të OSHP-s me nr. OSHP:2024/0101 të dt.29.03.2024, si dhe nenit 97.1 Shkelje të rënda konsiderohen: pika h) Mos respektimi i vendimeve të OSHP-së, Paneli Shqyrtues bazuar në LPP dhe RRPP duhet të marrë masa ndëshkuese ndaj Autoritetit Kontraktues dhe ndaj Artan Fejzës, pasi që është duke i zhdukur provat e shkeljeve që ka kryer në këtë aktivitet, ka fshire refuzimin e kërkesës për ri-shqyrtim të datës 01.02.2024 pasi që e ka vërejtur se refuzimi i kërkesës për ri-shqyrtim ka qenë në kundërshtim me LPP-.

Me datën 26.03.2025 është publikuar një dokument i zbrazet (“blanko”) me titullin:

Drejtoria_e_Prokurimit_Policia_e_Kosoves-1_(1)_250326_113024 dhe atë mbi dokumentin e datës 01.02.2024, kjo tregon se është duke u munduar që ti fshehë (zhdukë) faktet e shkeljeve që ka kryer në këtë aktivitet, shih foton e mëposhtme si zhduken dëshmitë e shkeljeve!

Paneli Shqyrtues ka konstatuar ndër të tjera citat:

Neni 40 par.3 i RRPP-së

? Ju përkujtojë se moszbatimi i vendimeve të OSHP-së përbën vepër penale dhe se nga praktika gjyqësore deri më tani aq sa kemi njohuri janë ngritur 4 aktakuza ndaj zyrtarëve përgjegjës të prokurimit. Autoriteti kontraktues me rastin e zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit ka bërë shkelje të nenit 40 par.3 të RREGULLORE Nr.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK. Konform nenit në fjalë Procedura për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, dhe nxjerrja e njoftimit mbi vendimin e AK, do të kryhet nga AK brenda periudhës më të shkurtër të mundshme kohore dhe jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave. Vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe të arsyetuara, në veçanti për kontratat e një natyre komplekse, kjo periudhë mund të zgjatet për një afat shtesë prej 20 ditësh, ndërsa AK-ja në r-vlerësimin e fundit ka kaluar 112 dite kalendrike, apo 3fishin e kohës së përcaktuar me LPP dhe RRPP, ndërsa në total që nga data e dorëzimit të ofertave deri më 09.08.2024, kanë kaluar gjithsej 839 ditë kalendrike.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër “Astraplan” SH.P.K konsideron se Autoriteti kontraktues ka shkelur Neni 7 i LPP-së - Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi, Neni 72 i LPP-së - Dokumentacioni dhe informacioni shtesë, Neni 56 i LPP-së - Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave, Neni 59 i LPP-së - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, Neni 69 i LPP-së -Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale, Neni 72 i LPP-së -Dokumentacioni dhe informacioni shtesë, Neni 105 i LPP-së -Kompetencat e OSHP-së , Neni 9.1 & 9.2 të DT-s - Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, Neni 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit, paragrafi 2. Neni 40 par.3 i RRPP-së. Pas përshkrimit të fakteve të lartshënuara dhe gjendjes faktike, pasi që e plotësojmë kushtin tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët. nga paneli shqyrtues në OSHP kërkojmë që të merret: V E N D I M te APROVOHET si e bazuar ankesa e Operatorit Ekonomik ASTRAPLAN SHPK, lidhur me aktivitetin e prokurimit: NDERTIMI I STACIONIT POLICOR VERI PRISHTINË, me nr. Prokurimit 214-22-10936-5-1-1. Anulohet njoftimi mbi Vendimin e AK-s Policia e Kosovës për Anulimin e aktivitetit të lartpërmendur, dhe ky aktivitet i Prokurimit: NDERTIMI I STACIONIT POLICOR VERI PRISHTINË, me nr. Prokurimit 214-22-10936-5-1-1, kthehet në RI- VLERESIM OSHP-ja të lëshojë URDHËR ndaj autoritetit kontraktues konform nenit 105 par.2 pika 2.10 të LPP-së, për zbatimin e vendimeve PSH. Nr. 373/2023, OSHP: 2023/0762, vendimin OSHP:2024/0101, OSHP: 2024/0725, Vendim për Diskualifikim nr. 80-24 dhe kjo çështje duhet konsideruar “RES JUDICATA” konform nenit 105 par.2 pika 2.16 të LPP-së, pasi që është rast i përsëritur me pretendimet e njëjta ankimore, ku objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, Të iniciohet revokimi i certifikatës profesionale të prokurimit ndaj z. Artan Fejza - zyrtar përgjegjës i prokurimit pran Policisë së Kosovës, konform Nenit 25 par.8 të LPP-s si dhe konform Rregullores Nr.002/2024 për Prokurimin Publik Saktësisht nenit 97.1 Shkelje të rënda konsiderohen:

a), Mashtrimi, kërcënimi, apo ushtrimi i çfardo presioni ose ndikimi të çfardo lloji që ushtrohet ndaj zyrtarit të prokurimit ose në një personi tjetër të përfshirë në një aktivitet të prokurimit në mënyrë që zyrtari tjetër të kryej vlerësimin në kundërshtim me këtë ligj.

b)- Falsifikimi, fshehja apo eliminimi i dokumenteve gjatë zhvillimit të një procedure të prokurimit

d),- Mos respektimi apo shkelja e parimeve themelore të prokurimit publik të përcaktuar me LPP.

h), Mos respektimi i vendimeve të OSHP-së

k) Anulimi i aktiviteteve të prokurimit në kundërshtim me nenin 62 të Ligjit të Prokurimit Publik. sepse i njëjti ka bërë shkelje të rënda-“Recidivist” (te përsëritura) te LPP-s, sepse nuk ka zbatuar 4 vendime të cekura më lartë të OSHP-së, siç specifikohet në nenin 97 të Rregullores Nr.002/2024 për prokurim publik.

V. Po ashtu kërkojmë nga Paneli Shqyrtues i OSHP-së që konform nenit 131 të LPPs, të gjobitet Autoriteti Kontraktues Policia e Kosovës, për shkak të mos respektimit të urdhrit të OSHP-së, dhe atë konform praktikave të mëparshme të OSHP-së dënimi i AK-s duhet të jetë 50,000.00€ deri në 100,000.00 €

VI. Po ashtu kërkojmë nga paneli shqyrtues i OSHP-së që të iniciojë procedurë penale ndaj zyrtarit përgjegjës të prokurimit z. Artan Fejzës, për shkak të moszbatimit të vendimeve të OSHP-së.

Përgjigjja e AK-së ndaj kërkesës për rishqyrtim. Përgjigjja në pretendimet ankimore të OE ASTRAPLAN Sh.p.k. AK sqaron se asnjë nga pretendimet ankimore nuk qëndron për arsyt në vijim:

- Pretendimi juaj se AK ka shkelur nenin 40 par. 3 të rregullores 001 /2022 sqarojmë si ne vijim AK ka filluar ri-vlerësim të këtij aktivitetit të prokurimit, arsyeja e zgjatjes së vlerësimit është bërë për shumë shkaqe duke filluar nga vendimet e OSHP-se, pas vendimit të OSHP se ku lënda është kthyer në rivlerësimi ka formuar komision dhe pas përfundimit vlerësimit nga ana e komisionit ,lënda kthehet në rivlerësim nga ZPP brenda AK.

- Komisioni i fundit rivlerësimin e ka filluar me datën 14.01.2025 dhe ka përfunduar me datën 04.03.2025.perkete arsye ka ndodhur zgjatje e vlerësimit. Pretendimi juaj se AK ka bërë shkelje për arsye se vendimi e ka nënshkruar një zyrtarë tjetër për z.Artan Fejza dhe zyrtari cili ka nënshkruar vendimin dhe raportin e vlerësimit ka zbatuar urdhëratë e-zotëri Artan Fejzës këto janë plotësisht të pa vërteta dhe askush nuk merr urdhër nga askush po të gjitha respektojnë Ligjin dhe të gjitha vendimet brenda AK merret gjithmonë mbi bazën ligjore duke respektuar në tërësi ligjin dhe rregullat për prokurim publik. AK sqaron se raportin e vlerësimit e ka nënshkruar një zyrtar i cili është caktuar si zyrtar përgjegjës i prokurimit për këtë aktivitet të prokurimit dhe ky pretendim është i pabazuar.

- AK nuk ka bërë shkelje të nenit 7 pasi në asnjë formë apo mënyrë nuk ka diskriminuar apo favorizuar asnjë OE për faktin se AK ka shpallur procedurë të hapur për aktivitetin e prokurimit dhe të gjithë OE janë trajtuar të barabartë pasi i kanë pasur në të njëjtën kohë informata dhe gjitha kushtet për tenderin në fjalë. OE ankues është vlerësuar mbi bazën e kriterëve kualifikuese në dosjen e tenderit përkatësisht aftësitë teknike profesionale ku kërkesa në dosjen e tenderit AK në asnjë formë nuk ka vlerësuar mbi bazën e kërkesave tjera përveç atyre që kanë qenë në dosjen e tenderit

c Pretendimi juaj se AK ka shkelur nenin 56 nuk qëndron pasi AK nuk ju ka eliminuar për asnjë kriter apo kërkesë që nuk ka qenë në dosjen e tenderit, pasi në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë ka qenë kriter si ne vijim citoj "Kërkesa 2-Lista e stafit profesion të operatorit ekonomik me përbërje si ne vijim

- Një (1) Inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë - drejtimi konstruktiv (apo master jo bachelor) me minimum përvojë pime 5 vite pas diplomimit,

- Një (1) inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë dhe Arkitektur drejtimi Arkitektur (apo master jo bachelor) me minimum përvojë pune 5 vite pas diplomimit,
- Një (1) Inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë - Drejtimi Hidroteknik (apo master jo bachelor) me minimum përvojë pune 3 vite pas diplomimit,
- Një (1) Inxhinier i diplomuar i Elektroteknikës (apo master jo bachelor) me minimum përvojë pune 3 vite pas diplomimit,
- Një (1) Inxhinier i diplomuar i Makineris (apo master jo bachelor) me minimum përvojë pune 3 vite pas diplomimit,
- Një (1) Gjeodet I diplomuar, i Licencuar (Inxhinier, master, apo bachelor) me minimum përvojë pune 3 vite pas diplomimit" ndërsa janë kërkuar Dëshmitë dokumentare si ne vijim citoj "Dëshmi 2-Lista e stafit profesional duhet të jetë e nënshkruar dhe e vulosur nga OE dhe dëshmitë për secilin inxhinierë si ne vijim
- Kontrata ose para kontrata e punës valide me punëdhënësin,
- Diploma e inxhinierëve përkatës sipas lëmis së kërkuar e noterizuar,
- CV-it- e inxhinierëve,
- Referencat mbi përvojën e pimës (në referenca duhet të jen të saktësuara vitet e punës nga secili punëdhënësi),
- Për Gjeodet duhet te jetë edhe Licenca e punës valide.

Mbi bazën e këtij kriteri AK ka vlerësuar ofertën tuaj duke bere verifikimin e CV te inxhinierëve te dorëzuar nga ana juaj ne ofertën tuaj, AK ka bere edhe verifikime ne ATK dhe kemi konfirmime se ne këto CV ka informata jo te sakta dhe mbi bazën e këtyre verifikimeve te kryera ne harmoni te plot me nenin 52.7 te LPP AK e ka vlerësuar ofertën tuaj te papërgjegjshme.

•Pretendimi juaj se AK ka shkelur nenin 59 nuk qëndron pasi AK nuk ka ber shkelje te nenit 59 për faktin se te gjithë OE janë trajtuar ne baze te kërkesave ne dosjen e tenderit dhe vlerësimit ekzaminimi dhe krahasimi i ofertave është ber ne harmoni te plot me nenin 59 te LPP-se pasi oferta juaj nuk ka qen ne harmoni me LPP.

•Pretendimi juaj se AK ka ber shkelje të nenit 91&9.2 te DT-se Kërkesa mbi mundësitë teknike dhe/ ose profesionale nuk qëndron pasi AK nuk ka ber shkelje te Nenit 91&9.2 te DT-se AK sqaron ka bere verifikimin e CV te inxhinierëve ne ATK inxhinierë te cilët ne CV te e tyre kane deklaruar se kanë qen të punësuar ne kompaninë tuaj prej kësaj kohe ,dhe mbi këto CV AK ,ka shpreh dyshime ne bazë te këtyre dyshimeve ka bere edhe verifikimin ne ATK ne harmoni te plot me nenin 52 te LPP ZATK konfirmon se ne këto CV ka informata jo te sakta dhe mbi bazën e këtyre verifikimeve te kryera ne harmoni te plot me nenin 52 te LPP AK e ka vlerësuar ofertën tuaj te papërgjegjshme.

Kronologji mbi verifikimin e CV te inxhinierëve qe është bere ne harmoni te plot me nenin 52.7 ketë e vërtetojnë edhe dy interpretimet e KRPP qe thuhet qartë se kurdo qe AK ka dyshime mbi cilin do dokument ka te drejt te beje verifikime pra AK nuk ka kërkuar asnjë dokument apo kriter jashtë dosjes se tenderit mirëpo ka bere verifikim plotësisht mbi dokumentet dhe informata e dorëzuar nga vet OE ankues ne ofertën e tij.

Duke analizuar CV e inxhinierëve ku ne secilën CV shkruar qarte përvoja e punës shih me poshtë CV e tyre:

Për inxhinierët ne fjalë AK ka kërkuar nga OE përmes letrës standarde për sqarimin te tenderit me datën 11.01.2024 sqarime duke i kërkuar për periudhën e pimës te prezantuar ne CV ne kompaninë ASTRAPLAN Sh.p.k. mbi eksperiencën e pimës ta dëshmojë me ndonjërin nga këto dokumente shih letrën standarde mbi kërkesat e AK.

Në dokumentacioni e dorëzuar së bashku me ofertë ju si ofertues keni caktuar Menaxher të Kontratës z. Bedri Asllani dhe në CV e tij është evidentuar që ky inxhinier është si inxh. dipli. Arkitekturës në Astraplan SHPK nga viti 2021, mirëpo nuk keni prezantuar referencat në përputhje me evidentimin e përvojës në CV. Po ashtu ne kontratën keni të evidentuar që do të jetë i angazhuar vetëm 4 orë në ditë.

Andaj ju lutem të na dorëzoni dëshmitë lidhur me përvojën në Astraplan SHPK (referenca) dhe dëshmitë dokumentare lidhur me deklarinimin dhe pagesat tatimeve për kohen që ka qenë i angazhuar në kompaninë AstraPlan SHPK, si dhe një deklarata me shkrim se si do të mbuloni pjesën e plot të orarit, pasi që keni kontrata vetëm për 4 orë në ditë, ndërsa Menaxheri i projektit duhet të jetë gjatë gjithë orarit të punimeve.

Po ashtu me qenë se në kontratë bashkëpunimi dhe në CV e këtij inxhxnieri është nënshkrim elektronik, kërkojmë të sillni një deklarata shtesë nga ky Inxhinier që vërteton që ka nënshkrua këtë kontrata dhe po ashtu një deklarata që të gjitha evidentimet në CV janë të dhëna të vërteta. Te gjitha dëshmitë duhet te procedohen përmes sistemit te E- prokurimit.

OE ankues nuk ka arritur te dëshmojë asnjë dokument (Referencë, kontratë – para kontratë, pagesës te tatime apo pagës te kontributeve) mbi përvojën e pimës te deklaruar ne kompaninë ATRAPLAN Sh.p.k. me përjashtim te një deklaratë te nënshkruar nga vet inxhinierët për asnjë inxhinieri te prezantuar ne CV e larte shënuara.

AK në te njëjtën kohë ka dërguar për verifikim në harmoni të plot me nenin 52.7 te LPP-së ne ATK dhe nga ATK-ja kemi pranuar përgjigje se për periudhën e deklaruar ne CV te inxhinierëve nuk kanë te deklaruar dhe as te paguar asnjë tatim apo kontribut.

Shih komunikimin me ATK.

Mbi bazën e këtyre te prezantuar me lart konfirmojmë se OE ka prezantuar informata jo te sakta pran AK dhe ne kundërshtim te plot me LPP dhe deklaratën nen betim te nënshkruar nga vet OE.

•Pretendimi juaj se AK ka shkelur nenin 105 nuk qëndron pasi AK ka zbatuar vendimin e OSHP-se pasi ka krijuar komision te ri-vlerësimit sipas vendimit te OSHP dhe vendimi i komisionit te ri-vlerësimit është i pavarura dhe ky komision ka përfunduar vlerësim mbi bazën e fakteve dhe dëshmime te kësaj

lende.

- Pretendimi juaj se AK ka shkelur nenin 69 nuk qëndron pasi AK nuk ka ber shkelje te nenit 69 pasi ju nuk i keni plotësuar aftësitë teknike profesionale dhe keni informata jo te sakta.

- Pretendimi juaj se AK ka shkelur nenin 62 nuk qëndron pasi AK ne harmoni te plot me nenin 62 ka anuluar aktivitetin e prokurimit pasi nuk kemi pasur asnjë oferte te përgjegjshme. AK sipas vendimeve paraprake te OSHP ku ka formuar komisionin e ri-vlerësimit dhe ri-vlerësimi është ber mbi bazën e fakteve dhe te gjetura_qe kane_qen ne_ketë_lende, pra kemi-konfirmim nga-ATK-ja se CV e inxhinierëve te dorëzuara ne ofertën tuaj përmbajnë informata jo te sakta dhe si te tilla nuk janë te pranueshme, këto verifikime janë ne përputhje me nenit 52 te LPP- se, asnjë veprim i AK nuk është tendencioz apo me qellim për dëmtim te ndonjë OE, veprimet e AK kane_qen për zbatim te plot te LPP-se për te siguruar se procedura e prokurimit është ne përputhje te plot me LPP-në.

- Pretendimi juaj se AK ka shkelur nenin 72 nuk qëndron pasi AK nuk ka ber shkelje te nenit 72 pasi AK ne harmoni të plot me nenin 72 ka kërkuar sqarime nga OE për sqarime dhe plotësim. të CV te inxhinierëve te dorëzuar ne ofertën e OE e ku me ketë raste OE nuk ka arritur te dëshmojë, argumentoje asnjë nga kërkesat e AK për sqarim dhe plotësim te CV.

- AK refuzon kërkesën tuaj për rishqyrtim për faktin se OE është i papërgjegjshme pasi përmban informata jo te sakta e te cilat AK i ka verifikuar ne instucionet përkatës dhe kompetentc, AK ne asnjë forme apo mënyrë nuk ka shkelur kompetencat e OSHP sepse pasi sipas nenit 37 te rregullores për prokurim publik 001/222 neni 67 par. 7 thuhet citoje "Një vendim i OSHP-se për ri-vlerësim të përzgjedhjes së ofertuesve ose dhënies së kontratës nuk nënkupton një ndryshim në rezultatin fillestar" ne rastin konkret vendimi i OSHP nuk ka ndikuar për te shpallur ofertën tuaj te përgjegjshme pasi oferta juaj ka informata jo te sakta ne CV e inxhinierëve.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 02.04.2025 ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0209/2025, ndërsa me datë 02.05.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 2025/0209 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që lënda të trajtohet si çështje e gjykuar sipas vendimeve paraprake të OSHP-së.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. “Autoriteti kontraktues nuk pajtohet me raportin e ekspertizës . Ndërsa OE pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues ”

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raportin e ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritior lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit

si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “Astraplan” SH.P.K eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0209 ka vlerësuar si në vijim:

Pretendim i kryesor sipas ankesës nr.209/25 ka të bëjë me arsyen e eliminimit të OE, ku sipas AK-së I njëjti ka ofruar disa CV me të dhëna jo të sakta.

OE ankues pretendon se kjo çështje është trajtuar nga OSHP përmes vendimeve të PSH. Nr. 373/2023, OSHP: 2023/0762, vendimin OSHP:2024/0101, dhe 2024/0725, dhe kjo çështje duhet konsideruar “RES JUDICATA” konform nenit 105 par.2 pika 2.16 të LPP-së, pasi që është rast i përsëritur me pretendimet e njëjta ankimore, ku objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta.

Pas analizimit të ankesës dhe pretendimeve ankimore, si dhe vendimit të AK-së të publikuar me 22.07.2024, eksperti shqyrtues I propozon panelit shqyrtues që në pajtim me nenin 105, par.2, nënpar.2.16 këtë rast ta trajtoj si çështje të gjykuar pasi kemi të bëjmë me pretendimet të njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë përmes vendimit të OSHP -së nr.101/24, 725/24

Ndërsa lidhur me këtë aktivitet të prokurimit po ashtu janë lëshuar vendimet e OSHP-së 356/23, 373/23, 389/23 dhe 762/23.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjera, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde dhe qëllimin parësor të ankesave, Paneli konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, parashtrësat e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritior. Në këtë rast, Paneli Shqyrtues konstatimet e tij i bazoi kryesisht në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla,

të cilat mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit, sikurse në këtë rast.

Paneli Shqyrtues evidenton se lidhur me këtë aktivitet të prokurimit ka nxjerr edhe pesë vendime paraprake me nr. 2023/0356, 2023/00373, 2024/0389, 2023/0762, 2024/0101, 2024/0725. Në të gjitha këto vendime janë konstatuar shkeljet e autoritetit kontraktues i cili nuk ka vepruar konform dispozitave ligjore dhe kërkesave të NJK dhe DT. Katër (4) prej këtyre vendime kanë qenë po të njëjtit OE i cili është edhe tani ankues OE Astraplan SHPK dhe e ka përsëritur ankesën e tij për herën e pestë me nr. 2025/0209.

Paneli Shqyrtues ka mbështetur pretendimet e ankuesit si dhe përgjigjet e ekspertëve shqyrtues ku në mesin e tyre ka pasur edhe ekspert teknik të cilët i kanë klasifikuar këto pretendime si të bazuara. Kështu që, edhe Paneli Shqyrtues në bazë të atyre të gjeturave dhe shkeljeve të AK, aktivitetin e prokurimit katër (4) herë me radhë e ka kthyer në ri-vlerësim, me qëllim që AK të bëjë ri-vlerësimin e ofertave konform dispozitave ligjore.

Lidhur me këtë, Paneli, shpjegon po ashtu se Autoriteti Kontraktues (AK), në kuptim të nenit 1 dhe 6 dhe në përputhje me nenin 115 të Ligjit për Prokurim Publik, nga cilësia e saj si iniciues e këtij aktiviteti të prokurimit, kishte mundësinë të rishikonte sërish vendimin e saj bazuar në gjetjet e vendimeve paraprake të OSHP. Ligji specifikon se nëse AK vërteton se pretendimi ose të gjitha pretendimet janë të vlefshme dhe nuk janë refuzuar nga ankuesi, ata mund të ndërmarrin veprime korrigjuese të rekomanduara nga eksperti. Megjithatë, AK prapë e konsideron ofertën e OE ankues si të papërgjegjshme. Paneli Shqyrtues potencon se autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit të iniciuar në vitin 2022 vazhdimisht ka luajtur një rol dekonstruktiv dhe vlerësim të ofertave në kundërshtim me LPP, dhe sipas bindjes së këtij Paneli Shqyrtues AK qëllimisht ka prolonguar këtë aktivitet të prokurimit, për të cilin konsideron se tani më veq se e ka humbur kuptimin dhe qëllimin për të cilin është iniciuar konform nenit 1 të LPP. Andaj, për Zyrtarin Përgjegjës të Prokurimit shqipton vërejtje për stërzgjatje dhe prolongimi të këtij aktiviteti të prokurimit dhe shkelje të vazhdueshme dhe mos respektim të vendimeve të OSHP, veprime këto të cilat janë në kundërshtim me nenin 97 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurim Publik, ku sipas këtij neni tek pika h), Mos respektimi i vendime të OSHP, konsiderohet shkelje e rëndë në Prokurimin Publik.

Andaj, Paneli shqyrtues përfundimisht, bazuar në të lartcekurat sqaron se kjo çështje sipas këtyre pretendimeve tani më konsiderohen të trajtuara, bazuar në nenit 105, paragrafi 2.15, të Ligjit për Prokurimet Publike (LPP), i cili parashikon se në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar “res judicata”. Po ashtu, PSH thekson se mbetet në përgjegjësinë e vet të AK Policia e Kosovës të anuloj këtë procedurë të prokurimit, përkundër të gjeturave të Paneleve Shqyrtues.

Megjithatë, Paneli Shqyrtues duke u nisur nga neni 104 par. 4 të LPP ku përcaktohet se “*Në ndërmarrjen e masave të përcaktuara OSHP duhet të veprojë në mënyrë proporcionale me shkeljen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke*

përfshirë interesin publik”. Detyrohet të marrë parasysh parimi themelor për mbrojtjen e interesit të publikut në aspektin e parandalimit të vonesave të paarsyeshme.

Kështu që, PSH vendos ta lë në fuqi vendimin e AK, vendim ky i njëjtë i cili i prinë edhe disa vendime paraprake që janë nxjerrë nga komisione të vlerësimit të cilët supozohen të jenë profesional dhe po ashtu përgjegjës sipas nenit 59.1 cituar “*Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës*”. Atëherë në zbatim të nenit 1 të LPP-së dhe me qëllim që mos ta prolongohet ky aktivitet të prokurimit edhe më tutje dhe paneli vlerëson se është në përgjegjësi të AK anulimi dhe zhvillimi i deritanishëm i kësaj procedure.

Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht në pajtim me kapacitetin buxhetor, edhe në neni 24 paragrafi 2 të LPP cituar “Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj”.

Andaj, Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të aprovet si pjesërisht e bazuar, por e pa mjaftueshme dhe e paarsyeshme që aktivitetin e prokurimit ta kthej sërish në ri-vlerësim dhe të prolongoj aktivitetin e prokurimit edhe më tutje. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues – “Policia e Kosovës” lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “NDERTIMI I STACIONIT POLICOR VERI PRISHTINË” me nr. të prokurimit: 214-22-10936-5-1-1, vetëm për shkak se kjo lëndë ka humbur edhe qëllimin dhe arsyet për të vazhduar sërish me ri-vlerësim të ofertave.

Bazuar në kompetencat e OSHP të parapara me nenin 105, lidhur me nenin 106 të LPP, Paneli Shqyrtues vuri në zbatim përveç nenit 1 dhe 6 mes tjerash edhe nenet 103 të Ligjit për Prokurim Publik të cituar sipas të cilit të gjitha palët e interesuara do të kenë qasje të barabartë në procedurat për shqyrtimin e prokurimit dhe në mjetet juridike dhe se, asnjë vendim i OSHP, nuk do të merret ose bëhet në mënyrën me të cilën diskriminohet në të mirë ose në dëm të një pjesëmarrësi në procedurë ose të një personi ose ndërmarrje tjetër, si dhe në nenin 104 të LPP.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, në pajtim me nenin 117 të LPP.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - POLICIA E KOSOVËS**
- **OE - Astraplan SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: